

7.	Plemetin	05.08.2021	Private	Djegje e ushqimit të kafshëve	VI-654- 13.08.2021	
8.	Bajmofc	02.08.2021	Private	Djegje e pemëve-kumbulla	VI-655- 13.08.2021	
9.	Breznicë	15.08.2021	Shoqërore	Zjarr fushor-djegje e gjësendeve dhe shtëpizë së metalit të AMF-së	VI-670- 17.08.2021	
10.	Mazgit	05.08.2021	Private	Djegje e dërrasave	VI-675- 17.08.2021	
11.	Breznicë	05.08.2021	Private	Djegje e gypave të ujit të rrjetit pikë-pikë	VI-676- 17.08.2021	
12.	Sibofc	11.10.021	Private	Djegje e shtallës dhe ushqimit të bagëtive	VI-855- 15.10.2021	
13.	Gjithsejt					1

Në vitin 2021 kanë ndodhur 12 raste të zjarreve të cilat janë të raportuara me shkrim

1. Zjarret sipas pronësisë:

➤ Pronësi shoqërore -----1

➤ Pronësi private -----11

Inspektimet nga lëmia e mbrojtjes nga zjarri –(MNZ-së ) gjatë viti						
Nr.	Përshkrimi	Subjekti	Vendi	Data e inspektimit	Shoqërore	Private
1.	Inspektim fillestar	VIVA FRESH STORE	Obiliq	29.04.2021	//	Private
2.	Inspektim fillestar	Agrofresh	Mazgit	29.04.2021	//	Private
3.	Inspektim fillestar	N.T.P.Risi	Obiliq	29.04.2021	//	Private
4.	Inspektim fillestar	Americanschool	Shkabaj	19.05.2021	//	Private
5.	Inspektim fillestar	BLB&BLB-	Obiliq	19.05.2021	//	Private

		GROUP				
--	--	-------	--	--	--	--

Gjatë vitit 2021 kanë kryer 5 inspektime:

Llojet e inspektimit:

1.Fillestare:5

2.Të rregullta -nuk ka

3.Verifikuese-nuk ka

Pronësia e subjekteve:

1.Shoqërore-nuk ka

2.Private- 5

Shpenzimet e derivateve gjatë vitit 2021

Shpenzimet e naftësëveturavepërvitin 2021			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	982.03	812.04
2	Shkurt	618.03	539.35
3	Mars	759.07	679.22
4	Prill	826.24	741.96
5	Maj	831.81	766.68
6	Qershor	1,046.40	999.52
7	Korrik	1,294.97	1,259.36
8	Gusht	1,191.26	1,141.47
9	Shtator	755.84	754.93
10	Tetor	1,108.08	1,204.27
11	Nëntor	1196.81	1277.59
12	Dhjetor	960.53	993.38
<b>Total</b>		<b>11571.07</b>	<b>11169.77</b>

Shpenzimet e benzinësëveturavepërvitin 2021			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	546.07	446.41
2	Shkurt	676.03	585.85
3	Mars	664.55	606.87
4	Prill	666.02	611.41
5	Maj	512.08	476.18
6	Qershor	562.04	538.83
7	Korrik	517.04	515.33
8	Gusht	652.03	640.49
9	Shtator	491.02	494.95
10	Tetor	713.06	757.55
11	Nëntor	665.48	690.50
12	Dhjetor	588.07	596.83
<b>Total</b>		<b>7253.49</b>	<b>6961.20</b>

Shpenzimet e naftës së Minibusave për vitin 2021			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Janar	358.04	296.06
2	Shkurt	792.01	691.19
3	Mars	821.05	734.68
4	Prill	565	507.37
5	Maj	740.01	682.07
6	Qershor	787.95	752.65
7	Korrik	100	97.25
8	Gusht	0	0
9	Shtator	150	149.82
10	Tetor	713.06	757.55
11	Nëntor	790.03	843.36
12	Dhjetor	870.08	899.64
<b>Total</b>		<b>6687.23</b>	<b>6411.64</b>

Shpenzimet e naftës së përgjeneratorit për vitin 2021			
Nr	Muaji	Litra	Vleranë euro
1	Dhjetor	546.00	549.22

- Shpenzimet e energjisë elektrike gjatë vitit 2021

Sh

Shpenzimet e energjisë elektrike për periudhën Janar-Dhjetor 2021									
N R	MUAJI	Komuna	Aneksi objektit komunal	Shtëpia e kulturës	Palestra e sportit	Fushë sportive	Fushë sportive	Ndriçimi	XhavitH aziri
1	JANAR	1,678.61 €	403.94 €	96.29 €	164.83 €	4.06 €	11.06 €	8,102.88 €	
2	SHKURT	1,296.33 €	374.30 €	116.76 €	209.37 €	3.80 €	14.49 €	6,182.91 €	
3	MARS	1,479.55 €	338.10 €	123.28 €	209.10 €	3.66 €	10.37 €	6,550.54 €	28.84 €
4	PRILL	1,063.71 €	263.76 €	105.70 €	146.16 €	3.78 €	15.08 €	5,853.87 €	28.12 €
5	MAJ	373.82 €	101.00 €	62.48 €	74.24 €	4.24 €	15.38 €	5,153.24 €	24.09 €
6	QERSH OR	375.05 €	41.16 €	100.68 €	109.92 €	3.59 €	24.44 €	4,849.33 €	22.54 €
7	KORRIK	435.63 €	50.27 €	115.13 €	60.65 €	4.19 €	28.59 €	4,590.83 €	21.28 €
8	GUSHT	1,384.97 €	40.69 €	118.28 €	76.33 €	6.44 €	27.91 €	5,279.76 €	23.18 €

		€							
9	SHTATO R	701.49 €	33.75 €	123.52 €	82.90 €	7.35 €	20.02 €	6,104.49 €	27.38 €
10	TETOR	1,425.74 €	183.49 €	204.50 €	158.33 €	4.26 €	31.87 €	6,969.24 €	29.68 €
11	NËNTO R	1,780.62 €	316.46 €	100.96 €	182.65 €	5.00 €	25.17 €	9,360.11 €	32.85 €
12	DHJETO R	1,727.63 €	417.32 €	106.56 €	181.31 €	3.49 €	22.47 €	9,787.93 €	38.45 €
<b>Total përmuaj</b>		<b>13,723.15 €</b>	<b>2,564.24 €</b>	<b>1,374.14 €</b>	<b>1,655.79 €</b>	<b>53.86 €</b>	<b>246.85 €</b>	<b>78,785.13 €</b>	<b>276.41 €</b>
<b>Totali Vjetor</b>		<b>98,679.57 €</b>							

- Shpenzimet e ujit gjatë vitit 2021

Shpenzimet e ujit për periudhën Janar-Dhjetor 2021				
NR	MUAJI	Komuna	Palestra e sportit	Zyre komunale
1	JANAR	17.83 €	49.68 €	47.09 €
2	SHKURT		56.59 €	43.63 €
3	MARS	75.60 €	57.45 €	45.36 €
4	PRILL		54.87 €	47.96 €
5	MAJ	28.94 €	56.59 €	50.54 €
6	QERSHOR	31.54 €	54.87 €	47.09 €
7	KORRIK	174.96 €	60.91 €	48.82 €
8	GUSHT	114.48 €	56.59 €	63.50 €
9	SHTATOR	87.69 €	58.32 €	51.41 €
10	TETOR	28.94 €	57.45 €	52.27 €
11	NËNTO	754.70 €	57.45 €	52.27 €
12	DHJETOR	99.60 €	58.32 €	41.90 €
<b>Total</b>		<b>1,414.28 €</b>	<b>679.09 €</b>	<b>591.84 €</b>
<b>Total 2021</b>		<b>2,685.21 €</b>		

## DREJTORIA E INSPEKSIONIT – RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021

Drejtoria e Inspektionit , gjatë kësaj periudhe ka punuar me plan- programin e punës për këtë vit duke u bazuar në kompetencat të cilat janë derivat i Ligjeve dhe Udhëzimeve Administrative, Rregullore Komunale. Për këtë periudhë kemi kryer punë të përditshme që e karakterizojnë këtë drejtori.

Vërehet një ngritje e dukshme e kapaciteteve të punës në disa inspektime krahasuar me periudhën e njëjtë të viteve paraprake.

Prioritet gjatë kësaj periudhe kohore i kemi dhënë:

- Parandalimin e COVID 19.
- Zonë me Interes të Veçantë Ekonomik (ZIVE).
- Pranimit dhe shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve.
- Inspektimit në fushën e ndërtimeve.
- Inspektimeve në komunikacionin rrugor.

Inspektimeve në lëmin e tregut

- Inspektimeve në sanitari etj.

Raporti i punës së Drejtorisë së Inspektionit është i përgatitur për secilin inspektorë veç e veç, ndërsa në vijim më në detaje janë të pasqyruara në formë tabelave dhe me përshkrim inspektimet për secilën lëmi.

Me respekt...

Raporti i përgjithshëm një vjeçar i punës për vitin 2021 në formë tabelave:

Janar - Dhjetor 2021	
Numri i inspektimeve me Procesverbal	566
Kërkesa për t'u pajisur me Pëlqim për kushte higjieno-sanitare	48
Aktvendim për ndalim të punimeve	28
Aktvendim për rrenim	25
Urdhër ekzekutimi për rrënim	20
Gjoha mandatorë	34
Aktvendim për gjoha mandatorë	34
Kërkesë për Gjykatë	1
Lëndë të proceduara te Përmbaruesi	3
Raporte finale për objekte të përfunduara	8

Kërkesë për kallxim Penal	2
Vendim për izolim COVID 19	1795
Vendim për shfuqizim COVID 19	1795
Inspektim i përbashkët me Policinë e Kosovës	12
Kërkesë për asistencë - S.P.Obiliq	12
Inspektime në shoqërim me AUV - in	695
Asgjësim të produkteve	20
<b>Kërkesa totali</b>	<b>182</b>
Në proces	17
Miratuara	133
Refuzuara	23
Hedhur poshtë	7
Anuluara	2

Nr.	Raporti i punës - Inspektori i Tregut 12 mujor 2021	Gjithësejt	Vërejtje
1	Numri i inspektimeve të përgjithshme (vërejtje, qortime)	1345	
2	Inspektime me procesverbal	187	
3	Pëlqime- me komision për kushte-higjieno sanitare	48	
4	Refuzime dhe mbyllje	3	
5	Kërkesa nga palët	48	
6	Inspektime në shoqërim me AUV - in	695	
7	Inspektime të ndryshme	357	
8	Aktvendime – gjoba mandatore	3	
9	Asgjasim	6	

Gjatë kësaj periudhe kohore të inspektimit si prioritet kemi pasur:

- Regjistrimin e bizneseve të reja.
- Vendosjen e çmimeve dhe të orarit të punës.

- Kontrollimin e dhënies së faturave shitëse e, blerësve-konsumatorëve.
- Kontrollimin e deklaracionit të mallit-kualitetin, shërbimet.
- Kontrollimi i te gjitha subjekteve afariste që bëjnë transportimin e mallrave nga subjekti te subjekti tjetër, kontrollimi i dokumentacionit përcjellës.
- Inspektimi i kushteve teknike te subjekteve afariste tregtare që merren me shumicë dhe pakicë , dhe subjektet shërbyes etj.
- Kontrollimi i peshojave (kalibrimi i tyre).
- Bashkëpunimi me inspektoratet qendrore dhe ndër komunale si dhe me Policin e Kosovës.
- Pranimi dhe shqyrtimi i kërkesave eventuale.
- Inspektime për parandalimin dhe luftimin e sëmundjeve ngjitëse COVID-19 duk u bazuar ne vendimet e Qeverisë dhe ligjin për COVID -19 .

<b>Nr.</b>	<b>Raporti Vjetor i Punës 2021</b>	<b>Gjithsej</b>	<b>Emri Palës</b>
1	Inspektime të përgjithshme	1553	
2	Inspektime me procesverbal	156	
3	Inspektime në Komunikacion	58	
4	Inspektime në lëmin e Sanitarit	98	
5	Vërejtje me shkrim	32	
6	Vërejtje me gojë	153	
7	Kërkesë nga palët	21	
8	Pranime me Komision	48	
9	Kërkesë për Polici	3	
10	Inspektim me Polici	12	
11	Lëndë për Gjykatë	1	
12	Thirrje për palë	5	
13	Lëndë për Përmbarues	3	
14	Aktvendim për izolim	1795	
15	Aktvendim për shfuqizim	1795	

16	Gjoba mandatorë	15	
17	Aktvendim për gjobë	15	
18	Njoftim për palë	2	
19	Kërkesë për Rendë udhëtimi	1	
20	Varrim të personave me COVID 19	22	
21	Asgjësim të produkteve	14	

Inspektori Sanitar - Komunikacionit gjatë këtij viti kalendarik Sipas planit të punës, jemi përkushtuar ti kryejmë të gjitha punët të cilat na obligon vendi i punës ti zbatojmë Ligjet dhe Rregulloret në fuqi s'i, dhe të gjitha urdhëresat e dhëna nga Drejtori dhe Udhëheqësi. Gjatë kësaj periudhe kohore kemi bërë 1553 Inspektime të përgjithshme , kemi bërë 156 procese ,96 procese në lëmin e Sanitaris dhe 58 në Komunikacion, 18 kërkesa nga palët, 2 njoftime për palët, 3 kërkesa për polici, 15 Vendime për gjoba, 3 lëndë për përmbarues, 1 lëndë për Gjykatë, 1 një propozim për revokim të Rendë udhëtitimit, 1795 Aktvendime për izolim, 1795 Aktvendime për shfuqizime, 22 monitorim të varrimeve me COCID 19, 14 asgjësime të produkteve, 9 nga to kanë qenë me kërkesë nga palët, 153 vërejtje ,sugjerime me gojë krysisht lidhje me zbatimin , njoftimin e vendimeve të Qeverisë për masat anti COVID 19 Gjatë këtij viti kalendarik rënësi të veçante i kemi kushtuar masave anti COVID-19 në përgjithësi e krysisht jemi marrë me zbatimin e vendimeve të dala nga Qeveria e Kosovës si dhe kemi nxjerr vendime për vet izolim të prekur nga COVID-19 dhe shfuqizimeve të këtyre vendimeve. Ku numri i tyre është i dhënë edhe në formë tabelore. Gjatë kësaj periudhe kemi pasur edhe inspektime jashtë orarit të punës – kujdestari.

Raporti vjetori për vitin 2021 në sektorin e ndërtimit në formën e shkruar dhe në menyr tabelare: 38 Procesverbalet. 93 Procesverbalet në shoqërim, 10 Aktvendimet për ndalim, 5 Vendimi për rrenim, 5 Urdhër për ekzekutim, 3 Gjoba mandatore , 3 Kërkesë për policinë, 4 Kërkesa nga palët , 6 Thirrje për palën, 2 Kallëzime penale.

Nr	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Procesverbalet	4	2	6	5	1	4	5	5	0	1	5	0
2	Procesver. Ne shoqërim	2	10	21	15	5	3	5	12	0	6	7	7
3	Aktiv.Ndalimi	0	0	4	2	0	1	2	1	0	0	0	0



4	Vend.Rrenimi	1	0	1	0	0	1	0	2	0	0	0	0
5	Urdher Ekz.	1	0	1	0	0	1	0	2	0	0	0	0
6	Vendim pano	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
7	Gjobat	0	0	0	0	1	1	0	1	0	0	0	0
8	Kërkesë policisë	1	0	2	0	0	1	0	0	0	0	0	0
9	Pëlqime ( PTL )	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
10	Kërkesa nga palët	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	3	1
11	Thirrje	0	0	0	0	0	4	1	1	0	0	0	0
12	Kallzime penale	1	0	0	0	0	1	0	0	0	0	0	0

Lidhur me Pandeminë Covid 19 kemi qenë të angazhuar në vendime të nxjerrura nga Qeveria e Republikës së Kosovës.

Gjatë vitit 2021 unë si kryetar i komisionit për evidentim dhe largim të banoreve të kompleksit banesor-afarist Hade dhe Hade 2 kemi punuar në evidentimin dhe largimin e banorëve nga kompleksi banesor si komision në përbërje: Fitim Dedinca Kryetar, Sami Haziri anëtar dhe Naim Querkezi anëtar.

Bazuar në kërkesën nga ana juaj lidhur me Procesverbalet dhe aktvendimet e ndërmarra në sektorin e ndërtimit, gjendja është si vijon në formën tabelare:

Nr	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	Procesverbalet	2	2	9	4	6	6	7	10	11	8	7	4
2	Procesver. Ne shoqerim	2	7	12	11	3	5	3	4	4			
3	Aktiv.Ndalimi			2		1	2					1	
4	Vend.Rrenimi		1	6			1		4				
5	Urdher Ekz.		1	1	5			1	2				
6	Gjoba			1	1								
7	Kërkese për		2		1					1			1

	<b>dshp</b>												
8	<b>Kerkese policisë</b>		2		1					1			1
10	<b>Kërkesa nga palët</b>			1	2	3	2	1	4	6	8	5	2
11	<b>Thirrje</b>		1	1					2		1		
12	<b>Kallzime penale</b>												
13													

Në detyrat shtesë bazuar në Ligjin Nr.06/L-007 për luftimin dhe parandalimin e pandemisë dhe me vendimin nga Kryetari i komunës Nr.II-1686 nga data 17.12.2020 gjatë viti 2021 në cilësinë e Kryetares së komisionit kamë administruar gjithësejt 2146 raste dhe janë krijuar 2146 lëndë të raportuara në 9 raporte me shkrim.

Kam shpërndarë vendime për izolim kur inspektori sanitarë ka qenë në pushim vjetorë apo kur ka shfrytëzuar ditët e lira.

Bazuar në kërkesën nga ana juaj lidhur me raportin vjetor 2021, ju paraqes raportin lidhur me inspektimet, Procesverbalin dhe Aktvendimet e ndërmarra në zonën 3 të ndërtimit , gjendja është si vijon në formë tabelore.

Nr	Përshkrimi	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1	<b>Procesverbalet</b>	5	10	15	23	4	5	/	7	3	6	3	3
2	<b>Procesver ne shoqërim</b>	3	3	16		7	7	2	2	3	3	11	2
3	<b>Aktiv.Ndalimi</b>	0	3	1	3			0	2				
4	<b>Vend.Rrenimi</b>	5											
5	<b>Urdhër Ekz.</b>	5				1							
6	<b>Ndërtime pa Leje</b>	5	8	4	10	2	0	0	2	0	1	0	0
7	<b>Ndërtime me</b>	0	1	3	8	3	5	0	2	3	5	7	2

	Leje												
8	Kërkesë Policisë	1			1	2							
9	Raporte finale										1	1	1
10	Inspektim me kërkesë	5	1	4	7	4	5	0	4	3	4	7	3
12	Gjobat		2	2	4				1				
13	Kallëzime penale												

Kjo është pasqyra në mënyrë tabelore sa i përket inspektimeve me përjashtim të inspektimeve të përbashkëta me njërin prej katër 4 inspektorve të ndërtimit, që nuk i ka të paraqitura inspektimet në polder në folderin e inspektimeve.

Ndërsa lidhur me Pandeminë Covid-19 kemi qenë të angazhuar në forma të ndryshme sipas Vendimeve të nxjerra nga Qeveria e Kosovës dhe me rekomandim nga organet udhëheqëse të komunës sonë.

**- Zonën e 4 katër**

Nr.	Raporti vjetor I punës Z-4	Gjithsejtë
1.	Procesverbal për kontrollin inspektues	24
2.	Vendim për rrënim Nr.	/
3.	Urdhër ekzekutimi për rrënim Nr.	/
4.	Aktvendim për ndalim Nr. 2 raste individuale 1 rastë biznesi	3 2 1
5	Inspektime në faza : 4 + 20 raste asistencë Inspektime ne faza zavendsime Asistencë për insp.faza Teuta Grajqevcin Zavendsim Teuta Grajqevcin ne insp. në faza Zavendsim Ibrahim Krasniqin ne insp. në faza	24 2 20 2 2
6.	Urdhëresë për pagesë për ndeshkim gjobë mandatore	2
7.	Aktvendim për gjobë	2
8.	Të realizuara	2

9.	Kerkese për raporte final <b>Raporte Finale:</b> dy biznese tri individuale	5 5 2 3
10.	Inspektime me kërkesë të qytetarëve	5
11.	Inspektime në shërbime komunale Asistencë inspektorëve të mjedisit Asistencë inspektorit të komunikacionit Asistencë fitim Dedincen ( rast uzurpimi) Asistence për inspektim të objekteve në pronën publike Plemetin	5 2 7 1 3
12.	Procese për Covid 19 Ligji Nr.07/L-006 Asistencë me AVUK	2 32

Në tekstin më poshtë po japim një përshkrim të detajuar në lidhje me përshkrimin tabelorë.

#### **Inspektimet**

Në lëmin e ndërtimit 12 procese që kanë të bëjnë me ndërtim pa leje ose inspektime në faza të objekteve me leje ndërtimit për zonën e përgjegjësive nr. 4

Dymbëdhjetë (12) procese janë në fushën e ndërtimit.

Dy (2) procese janë me Ligjin për pandemi

Pesë (5) procese në lëmin e shërbimeve komunale me shefin për Ndërmarrjen Pastrimi-inspektim i kamionëve.

Pesë (5) procese me kërkesën e qytetarëve në lëmin e shërbimeve komunale (Shipitullë, Mazgit, Dardhishtë, Mirash)

**Asistence:** Inspektorin e Komunikacionit në 7 raste

**Inspektoren e ndërtimit Teuta Grajqevci** në të gjitha fazat e ndërtimit tek: Alko Group dhe Fontana.

**Inspektorin Fitim Dedinca:** Në Inspektim për Uzurpim në Millosheve

**Inspektorin Ibrahim Krasniqi:** Mbikqyrje në faza në Parkun e biznesit (zavendsim) të Kolegji i Biznesit

Inspektim në rrenimin e objekteve me karakter të përkohshëm në zonën publike në **Plemetin**

#### **Raporete Përfundimtare:**

Në këtë zone kanë përfunduar ndërtimet deri në finalizim gjithësejt 5 Objekte: dy (2) objekte afariste të kategorisë së dytë : American Scooll dhe Haje SHPK për të cilat objekte janë leshuar edhe raportet finale të cilat objekte janë paisur me leje të përdorimit si dhe tri(3) objekte individuale.

I kam leshuar tri vendime për ndalim ndërtimit dy objekte ekonomike individuale dhe një objekt afarist.

I kam bërë 2 gjoba 2 x 2000 euro për mosrespektim të urdhëreses dhe të njejtat janë paguar nga palët.

#### **COVID 19.**

Në detyrat shtesë bazuar në Ligjin Nr.06/L-007 për luftimin dhe parandalimin e pandemisë dhe me vendimin nga Kryetari i komunës Nr.II-1686 nga data 17.12.2020 gjatë viti 2021 në cilësinë e anëtarit të komisionit kam administruar gjithësejt 2146 raste dhe janë krijuar 2146 lëndë të raportuara në 9 raporte me shkrim.

Kam shpërndarë mbi 200 vendime për izolim si dhe kam bërë vendime për izolim ne periudhen kur inspektori sanitarë ka qenë në pushim vjetorë apo kur ka shfrytëzuar ditet e lira.

Në këtë periudhë kam asistuar në 32 raste në inspektim jashtë orarit të punës në inspektim të tejkalimit të orarit të punës për Markete dhe Gastronomi dhe në respektimin e masave anti Covid 19 me inspektorët e AVUK ku kemi bërë me shumë se 20 procese ku bartës të detyrave kanë qenë inspektorët e caktuar nga Ministria e Shëndetësisë ndërsa une kam asistuar dhe kam nënshkruar të gjitha masat e marra në teren.

### **DREJTORIA PËR PLANIFIKIM URBAN, PRONË, KADASTËR DHE GJEODEZI – RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-31.12.2021**

#### **Drejtoria për Planifikim Urban, Pronë, Kadastër dhe Gjeodezi**

Drejtoria e DPUPK është e ndarë në katër sektore, sektori i Urbanizmit, Pronës dhe Çështjeve pronësore juridike, Kadastrit dhe Gjeodezisë, ku secili nga këta sektorë është i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme. Të gjithë sektorët punët i kanë përfunduar me përkushtim të plotë duke i respektuar normativat ligjore në fuqi dhe afatet ligjore, duke u ndarë të knaqur edhe me qytetarët edhe me vetë eprorët që është dashur të raportojnë për punët e përfunduara.

Kështu puna e kryer gjatë viti 2021 ka qenë një punë produktive dhe këto punë po i paraqesim më poshtë për çdo sektorë veq e veq:

#### **-SEKTORI I PRONËS-**

Gjatë vitit 2021 Sektori i pronës dhe çështjeve pronësore juridikenë kuadër të DPUPK-së ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë për vitin në fjalë si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësitë brenda Komunës, pjesëmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme e shumë punë të tjera të lidhuar me këtë sektor, ku të gjitha këto aktivitete janë përmbyllur me sukses brenda afateve ligjore gjatë tërë viti.

Përveç punëve të cilat janë kryer si përshembull në bartjen e pronës në regjistrimin dhe fshirjen e hipotekës dhe regjistrimin e ngarkesave të tjera , ligjore si barrë tatimore etj, po ashtu janë kryer shpronësime për interes të përgjithshëm, me iniciativën e kryetarit janë përgatitur propozim vendime për Kuvend për dhënien e pronës komunale në shfrytëzim afatgjatë në zonën Industriale zona kadastrale Llazarevë të cilat do t'i paraqesim si në vijim :

- Me dt.22.02.2021 përmes Kryetarit të Komunës , Drejtoria jonë përmes Kërkesës nr.V-203 ka kërkuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit që Njësia Kadastrale P-72614055-01850-37 me sipërfaqe prej 160 m<sup>2</sup> z.k.Obiliq e evidentuar në emër të P.SH. Industria e Derivateve të Naftës që njësinë e lartcekur mos ta përfshijë në procesin e privatizimit meqenëse parcela gjendet Pompa e Derivateve të naftës do të iniciohet procesi i shpronësimit përmes Departamentit të Shpronësimit të MMPHI-së për nevojat e interesit të përgjithshëm .

- Drejtoria jonë përmes kërkesës së radhës nr.V-251 dt.01.03.2021 i është drejtuar Drejtorit Menaxhues në Agjencinë Kosovare të Privatizimit atë kohë z. Valon Tolaj duke e njoftuar fillimisht se Komuna jonë është në proces të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal nëpërmjet të cilit do të planifikohet për 8 (tetë) vitet e ardhshme zhvillimi i Komunës sonë . Andaj mbi bazën e kësaj kërkojmë nga ana e juaj që të na njoftoni se a gjenden në procesin e privatizimit ngastrat kadastrale si në vijim :

- **P-72614055-00065-1**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore ; Lloji i shfrytëzimit të parcelës : Bujqësore ; Shfrytëzimi aktual i parcelës : Arat; kualiteti i klasës: Arë e kl.4 me sipërfaqe prej 248523 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 z.k. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ( Në këtë ngastër kadastrale gjenden varrezat e qytetit para vitit 1999) ;

- **P-72614055-00065-3**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore-kullosat– kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 8160 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 z.k. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00065-7**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore-kullosat – kullosë e klasës 2; me sipërfaqe prej 470 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00034-1**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 6; me sipërfaqe prej 18016 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00036-0**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 20258 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00037-0**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10841 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00038-0**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 10292 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** ;

- **P-72614055-00058-0**, Lloji i Pronës : Pronë Shoqërore; Shfrytëzimi aktual i parcelës :Bujqësore- Arat – Arë e klasës 5; me sipërfaqe prej 20471 m<sup>2</sup> ; Pjesa e Pronës 1/1 zk. Obiliq e cila evidentohet në emër të **KBI KOSOVA EXPORT – N.SH.BUJQËSIA** .

Për veq në ngastrën kadastrale **P-72614055-00065-1** ashtu siç u cek më lartë që gjenden varrezat e qytetit në ngastrat tjera si të cekura më lartë, Komuna e Obiliqit në seancën e radhës do t'i shpallë Zonë me Interes të Përgjithshëm si dhe planifikon realizimin e projekteve të ndryshme në dobi të qytetarëve, dhe nëse këto ngastra nuk gjenden në procesin e privatizimit nga ana e juaj ne si Komunë shumë shpejt do t'i drejtohem Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit gjegjësisht departamentit të shpronësimit për iniciimin e procedurës së shpronësimit për këto ngastra .

-Me iniciativën e Kryetarit të Komunës, Drejtoria jonë ka përpiluar Propozim Vendimin nr.II-96 dt.24.02.2021, përmes së cilit i është drejtuar Kuvendit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për

parcelën kadastrale P-72614055-01850-37 me sipërfaqe prej 160 m<sup>2</sup> zk. Obiliq , ne këtë propozim është dhënë edhe arsyetimi se për qfarë arsyetimi bëhet shpallja e interesit dhe se për se do të shpronësohet .

-Me iniciativën e Kryetarit të Komunës, Drejtoria jonë ka përpiluar Propozim Vendimin e radhës nr.II-97 dt.24.02.2021, përmes së cilit i është drejtuar Kuvendit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën kadastrale P-72602052-00804-26 me sipërfaqe prej 310 m<sup>2</sup> , ne këtë propozim është dhënë edhe arsyetimi se për qfarë arsyetimi bëhet shpallja e interesit dhe se për se do të shpronësohet .

-Me iniciativën e Kryetarit të Komunës, Drejtoria jonë ka përpiluar Propozim Vendimin e radhës nr.II-98 dt.24.02.2021, përmes së cilit i është drejtuar Kuvendit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale të cilat janë të përfshira në propozimin në fjalë e të cilat gjenden në zonën kadastrale në Obiliq ku pejë e këtyre parcelave gjendet edhe parcela nr.00065/1 e në të cilën gjenden varrezat e qytetit .

-Me iniciativën e Kryetarit të Komunës, Drejtoria jonë ka përpiluar Propozim Vendimin e radhës nr.II-98 dt.24.02.2021, përmes së cilit i është drejtuar Kuvendit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelat kadastrale të cilat janë të përfshira në propozimin në fjalë e të cilat gjenden në zonën kadastrale në Obiliq ku në mesin e këtyre parcelave gjendet edhe parcela nr.00065/1 e në të cilën gjenden varrezat e qytetit .

Po ashtu Kryetari ka marrë iniciativë që disa Njësi Kadastrale që gjenden në zonën kadastrale Mazgit përmes Propozim Vendimit Nr.II-99 dt.24.02.2021 dhe Nr.II-109 dt.25.02.2021 të paraqes shpalljen e interesit të përgjithshëm publik për Njësitë në fjalë e në të cilat pas procesit të shpronësimit i cili do të ndodhë në të ardhmen Komuna do të realizoj projekte të ndryshme e të cilat projekte do të jenë në shërbim të qytetarëve .

Përmes përgjigjes në kërkesë nr.V-2078 dt.15.12.2021 ,Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër Agjencisë Kosovare të Privatizimit që Njësia Kadastrale nr.1459/18 zk.Obiliq e që evidentohet në emër të PSH.ORG.PUNUESE QARK.PËR MBETURINA të mos përfshihet në procesin e privatizimit për arsye se Komuna planifikon këtë njësi ta shpronësoj për nevojat e interesit të përgjithshëm .

-Drejtoria e Infrastrukturës Lokale me kërkesën nr. XVII -298 dt.26.09.2019 ka kërkuar nga Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër inicimin e procedurës së Shpronësimit për parcelën P-72602025-



00784-2 zk.Plemetin me arsyetimin e realizimit të projektit kapital rrugë “Hoxhë Ali Querkezi” e cila lidh fshatrat e Qyqavicës përmes f.sh Plemetin me f.sh Milloshevë.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur miraton Propozim Vendimin me nr.II-1057 të dt.18.10.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur miraton Propozim Vendimin me nr.II-1057 të dt.18.10.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelen Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin.

Kuvendi i Komunës së Obiliqit në mbledhjen e mbajtur miraton Vendimin me nr.I-198 të dt.25.11.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin. Pas marrjes së Vendimin me nr.I-198 të dt.25.11.2019 për shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin, Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër kërkon nga DEFZH-ja Konfirmimin e mjeteve buxhetore për fillimin e procedurës së Shpronësimit.

Me shpalljen me interes të përgjithshëm publik për parcelën Kadastrale në Zonën Kadastrale në Plemetin, Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër përpilon Raportin Teknik me dt.27.08.2020.

DPUPK-ja bën kërkesë me nr.V-712 dt.15.09.2020 për Kryetarin e Komunës për inicimin e procedurës së shpronësimit për njësinë kadastrale në zk.Plemetin.

Kryetari i Komunës merr Vendim me nr.II-1129 dt.02.10.2020 për Aprovimin e kërkesës së DPUPK-së, bëhet Njoftimi me nr.II-1142 dt.08.10.2020 për pronarin e njësisë kadastrale se shpronësimi do të realizohet me qëllim të realizimit të projektit kapital i cili lidh fshatrat e Quqavicës përmes Plemetit me f.sh Milloshevë si dhe bëhet dorzimi i dokumentacionit komplet për zhvillimin e procedurës së Shpronësimit për pronarin e njësisë Kadastrale.

Me dt.22.10.2020 Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër në koordinim me Zyrën e Kryetarit të Komunës si bartëse e procesit në përputhje me legjislacionin në fuqi ka organizuar dëgjimin publik lidhur me shpronësimin e njësisë kadastrale .

Në dëgjim publik Drejtori i Drejtorisë para te pranishmeve sqaron interesin e përgjithshëm mbi bazën e te cilit do te behet shpronësimi , shpjegohen procedurat ligjore , dhe natyrisht i'u është dhënë mundësia e paraqitjes së pikëpamjeve të tyre për sa i përket projektit në fjalë .

Pas pranimit të raportit të vlerësimit të përgatitur nga zyra për vlerësimin e pronës se paluajtshme, Drejtoria e jonë ka përgatitur Vendimin Preliminar nr.II-220 dt.15.03.2021 përmes së cilit organi

shpronësues ka miratuar shpronësimin e njësisë kadastrale nr.P-72602052-00784/2 me te cilin janë njoftuar gjithë zotëruesit e interesit dhe i'u është dhënë mundësia e ankesës ne afat prej 30 dite ne Gjykatën Kompetente .

Po ashtu për t'a promovuar si organ administrativ sa më shumë transparencën komunale Drejtoria jone Vendimin sipas Ligjit për Shpronësim e ka publikuar në ëeb faqen zyrtare te Komunës dhe Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës përmes kërkesës nr.V-400 dt.23.03.2021 .

Kryetari i Komunës me dt.06.05.2021 miraton Vendimin Përfundimtar nr.II-398 e të përgatitur nga Drejtoria jonë përmes së cilit miraton shpronësimin përfundimtar të parcelës në fjalë me qka edhe përfundon procedura e shpronësimit për rastin në fjalë .

Ne vendimin e lartcekur shpjegohet te drejtat dhe detyrat e palëve te cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit .

Po ashtu edhe si me vendimin preliminar edhe vendimi përfundimtar është dërguar për publikim në gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i njëjti është publikuar edhe ne faqen zyrtare të Komunës .

Pas përmbylljes së këtij procesi ashtu siq e parashohin dispozitat ligjore në fuqi pronarit të parcelës i është bërë kompensimi i shpronësimit për njësinë kadastrale .

Rasti numër (2) lidhur me shpronësimit i cili është zhvilluar gjatë vitit 2020-2021, ka qenë rasti i shpronësimit i cili është bërë me kërkesën e Komandantit të Stacionit Policor Obiliq të cilin kronologjikisht po e paraqesim si në vijim :

-Me kërkesën Stacionit Policor në Obiliq Nr. Referencës :04/1-01O/112/2020 dt.16.06.2020 përmes së cilës kanë kërkuar shpronësimin e Njësive Kadastrale Nr.01869-0 dhe 1870-0 zk.Obiliq të evidentuar në emër të Rifat Grajqevci të cilat ju nevojiten për ndërtimin e parkingut për zyrtarët policor pasi që parkingu ekzistues para stacionit policor është rrënuar me rastin e ndërtimit të sheshit “ Sheshi Dëshmorëve “ , Drejtoria e Planifikimit Urban, Pronë dhe Kadastër e përgatit propozim Vendimin për Kryetarin e Komunës i cili pastaj kalon në Kuvend përmes së cilit është kërkuar shpallja zonë me Interes të Përgjithshëm për këto parcela dhe me dt.30.06.2020 Kuvendi i Komunës përmes Vendimit Nr.I-76 miraton propozim Vendimin në fjalë .

Pas analizimit të kërkesës dhe pas shqyrtimit të saj Drejtoria e Planifikimit Urban , Pronë dhe Kadastër dhe bazuar në Vendimin e Kuvendit nr.I-76 përmes kërkesës nr.V-713 dt.15.09.2020 paraqet te kryetari i komunës si organ shpronësues për inicim të procedurës për shpronësim të njësive kadastrale P-72614055-01869-0 dhe P-72614055-01870-0 zk.Obiliq .

Organi shpronësues pas analizimit të kërkesës dhe pas konsultimeve me Drejtorinë tone nxjerr vendimin nr.II-1128 dt.02.10.2020 përmes së cilit aprovohet kërkesa e jonë për inicimin e procesit të shpronësimit për njësitë në fjalë .

Organi shpronësues bazuar në ligjin e shpronësimit nxjerrë Njoftimin nr.II-1143 dt.08.10.2020 i cili i'u drejtohet gjithë palëve të interesit dhe në te njëjtin shpjegohen arsyet e shpronësimit dhe në te njëjtin ceket data e mbajtjes së dëgjimit publik ku ftohen gjithë ato palë të interesit që kanë për të paraqitur opinionet e tyre .

Me dt.22.10.2020 në ora 14:00 është organizuar dhe mbajtur dëgjimi publik sipas Ligjit të Shpronësimit ku të pranishëm ishin zyrtarët e Drejtorisë gjegjëse , zyrtarët policor si palë e interesit .

Drejtori i drejtorisë sqaron arsyet e këtij procesi dhe njofton për ecurinë e lëndës në fjalë , dhe nuk kemi pasur ndonjë pyetje konkrete nga ana e zyrtarëve policor .

Pas pranimit të raportit të vlerësimit të përgatitur nga zyra për vlerësimin e pronës se paluajtshme, Drejtoria e jonë ka përgatitur Vendimin Preliminar nr.II-221 dt.15.03.2021 përmes së cilit organi shpronësues ka miratuar shpronësimin e njësive kadastrale nr.P-72614055-01869/0 dhe P-72614055-01870/0 zk.Obiliq me te cilin janë njoftuar gjithë zotëruesit e interesit dhe i'u është dhënë mundësia e ankesës ne afat prej 30 dite ne Gjykatën Kompetente.

Po ashtu për t'a promovuar si organ administrativ sa më shumë transparencën komunale Drejtoria jone Vendimin sipas Ligjit per Shpronësim e ka publikuar ne ëeb faqen zyrtare te Komunës dhe Gazetën Zyrtare te Republikës së Kosovës përmes kërkesës nr.V-401 dt.23.03.2021 .

Kryetari i Komunës me dt.06.05.2021 miraton Vendimin Përfundimtar nr.II-397 e të përgatitur nga Drejtoria jonë përmes së cilit miraton shpronësimin përfundimtar te parcelës ne fjale me qka edhe përfundon procedura e shpronësimit për rastin ne fjalë .

Ne vendimin e lartcekur shpjegohet te drejtat dhe detyrat e palëve te cilat janë prekur nga procesi i shpronësimit .

Po ashtu edhe si me vendimin preliminar edhe vendimi përfundimtar është dërguar për publikim ne gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës dhe i njëjti është publikuar edhe ne faqen zyrtare te Komunës .

Pas përmbylljes së këtij procesi ashtu siq e parashohin dispozitat ligjore në fuqi pronarit të parcelës i është bërë kompensimi i shpronësimit për njësinë kadastrale .

- Sa i përket dhënies së pronës së paluajtshme të Komunës , me iniciativën e Kryetarit të Komunës janë dhe gjithsejtë 9 (nëntë) prona të paluajtshme në shfrytëzim afatgjatë si në vijim :
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-22 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-48 i është dhënë operatorit ekonomik “AZTECH SH.P.K.” ;
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-11 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-49 i është dhënë operatorit ekonomik “N.P. TRO – DEX” .
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-21 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-50 i është dhënë operatorit ekonomik “N.P.SH. TERMOPAN ;
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-10 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-51 i është dhënë operatorit ekonomik “ONEGROUP SH.A” ;
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-15 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-52 i është dhënë operatorit ekonomik “ BP HOME INVEST SH.P.K.”;
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-19 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-53 i është dhënë operatorit ekonomik “TEHNOBURIMI” D.D.SH.A” ;

- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-6 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-54 i është dhënë operatorit ekonomik “NMA SH.P.K.”;
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-7 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-55 i është dhënë operatorit ekonomik “N.T.P. EBF “ dhe :
- Njësia Kadastrale P-72614041-00124-20 sipas vendimit të Kuvendit Komunal Nr.I-56 i është dhënë operatorit ekonomik “NIC HOME SH.P.K.”

*Gjatë Vitit Janar-dhjetor 2021 kemi pas gjithësejt 1388 - kërkesa për lëndë të ndryshme dhe ate:*

<i>1. Kontrata te shtitblerjes</i>		<i>563</i>
<i>2. Kontrata per ndarjen e paluajtshmerisë</i>	<i>09</i>	
<i>3. Aktvendime të Trashëgimisë</i>	<i>47</i>	
<i>4. Regjistrim i Hipotekes</i>	<i>40</i>	
<i>5. Fshirje e Hipotekes</i>	<i>66</i>	
<i>6. Kontrata te faljes (Dhurimi)</i>		<i>112</i>
<i>7. Parcelizim (Ndarje)</i>		<i>108</i>
<i>8. Bashkim dhe ndarje</i>	<i>15</i>	
<i>9. Kthim i Kufijve</i>	<i>07</i>	
<i>10. Rexhistrim i Objektivit</i>	<i>03</i>	
<i>11. Rexhister i Kordinatave</i>		<i>146</i>
<i>12. Mase e Perkohshme</i>	<i>02</i>	
<i>13. Modifikim për Personin</i>		<i>137</i>
<i>14. Vendim Gjyqësor</i>	<i>03</i>	
<i>15. Kontrata te Qiramarrjes se Objektivit te Banimit</i>		<i>00</i>
<i>16. Kontrata te kembimit ( ndrrimi )</i>		<i>41</i>
<i>17. Parcelizim dhe Rregullim i Kufirit</i>		<i>01</i>
<i>18. Vendim Perfundimtar</i>		<i>00</i>

<i>20 Historiati i pronës</i>		<i>09</i>
<i>21. Vendim Shpronësimi</i>		<i>06</i>
<i>22. Vendim i Qeverisë</i>		<i>20</i>
<i>23. Barra Tatimore</i>		<i>04</i>
<i>24. Bashkim i Paçelave</i>		<i>16</i>
<i>25. Qiramarrje për 99 vite</i>		<i>18</i>
<i>26. Vendim për mbajtje të Perjetshme</i>		<i>01</i>
<i>27. Vrejtje nga Permbaruesi</i>		<i>04</i>
<i>28. Azhurim i gjendjes në Grafik</i>		<i>07</i>
<i>29. Bashkim dhe Rëxhëtrim i Paçelave</i>		<i>00</i>
<i>30. Dhenje në Shfrytëzim KK Obiliq</i>	<i>00</i>	
<i>31. Regjistrim i ndërtesës</i>		<i>00</i>
<i>32. Lirim nga barra Tatimore</i>		<i>00</i>
<i>33. Azhurim</i>		<i>00</i>
<i>34. Aktgjykim</i>		<i>01</i>
<i>35. Lirim nga Masa e Përkohshme</i>	<i>00</i>	
<i>36. Ankes</i>	<i>00</i>	
<i>37. Modifikim i Hipotekës</i>		<i>01</i>
<i>38. Marrëveshje me Ndermjetësim</i>		<i>01</i>

	<i>Cert. paluajtshmërisë</i>	<i>Kopje Plani</i>	<i>Cert. gjendje pronësore</i>
<i>Kërkesa</i>	<i>2860</i>	<i>1292</i>	<i>317</i>
<i>Të realizuara</i>	<i>2760x4+32</i>	<i>1206x4</i>	<i>164x3</i>
<i>Procedurë</i>	<i>0</i>	<i>0</i>	<i>0</i>
<i>Me bllok</i>	<i>4</i>	<i>0</i>	<i>0</i>

<i>Të lirume</i>	<i>100</i>	<i>86</i>	<i>153</i>
<i>totali</i>	<i>10688€</i>	<i>4824€</i>	<i>492€</i>
<i>Totali i përgjithshëm</i>	<i>16388€</i>		

*Te Hyrat Gjatë Vitit Janar –Dhjetor 2021*

*Gjeodezi Pronë dhe Kadaster janë: 60451 €.*

### **-SEKTORI I KADASTRIT-**

- Si piknisje Sektori i Kadastrit kujdeset për respektimin e ligjeve dhe mban përgjegjësi në zbatimin e ligjeve të Kadastrit dhe udhëzimeve administrative të nxjerra nga Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK), dhe se bashku me ta krijojnë metoda në avansimin e metodave të punes.
- Gjatë këtij viti kemi punuar ne realizimin e të gjitha kërkesave për qytetarët e Komunës, varësisht prej llojit dhe natyres së kërkesave të qytetarëve.
- Zhvillimin e procedurave te regjistrimit , sipas detyres zyrtare dhe kerkeses se paleve;
- Korrigjimin e regjistrit në Sistemin Informativ Kadastral të tokave të Kosovës (SIKTK) sipas procedurave dhe zbatimin e te gjitha dispozitave ligjore ne fuqi;
- Regjistrimin e pronave te paluajtshme dhe regjistrimin e pronave komunale;
- Azhurimin e pronave në bazë te dokumentacionit të leshuar nga Gjykatat kompetente, Noterët, Përmbaruesit si dhe organet pergjegjëse Vendimet e Kuvendit, Vendimet nga AKK-ja si dhe vendime tjera etj;
- Zbatimin e procedurave rreth transaksioneve te pronave private dhe shoqërore ne SIKTK-së ;
- Shqyrtimin dhe kryerjen e procedurave administrative per rikthimin e paluajtshmerisë ish-pronarit, evidentimin dhe shlyrjen e masave të perkohshme sipas aktvendimit të Gjykates kompetente;
- Udhëheqjen me kadastër etazhë të banesave ,ndertesave , pjesëve të ndërtesave si dhe ngastrat kadastrale ne te cilat jane ndertuar banesat;
- Regjistrimin dhe çregjistrimin e hipotekave ; Aktvendimeve mbi regjistrimin e servituteve, rexhstrimin e barrave tatimore;
- Lëshimin e certifikatave personave qe nuk kan patundshmeri, çertifikatave mbi te drejtat e prones se paluajtshme si dhe kopje planit;

- Mëmbajtjen, korrëjimin dhe harmonizimin e evidencave të vendbanimeve ,fshatrave ,shesheve,rrugeve dhe numrat e objekteve dhe ndërtesave;
- Nxerrjen e aktvendimeve për miratim e ndarjeve të parcelave, bashkimin e parcelave modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave;
- Nxerrjen e konkluzioneve për plotsimin e kërkesave të pakompletuara;
- Pergaditjen e projektprogramit të punës për nevojat e Drejtorisë dhe raportin të punës;
- Punë të tjera në pajtim me dispozitat ligjore(shpalljet publike, kërkesat për nevojat e Kuvendit, të gjykatave dhe institucioneve tjera).
- Zhvillimin dhe organizimin e sistemeve kadastrale, rikonstruimin e informatave kadastrale në formë digjitale , modelin e sistemit informatik për tokën dhe pronën;
- Regjistrimin e ndarjeve të parcelave dhe modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave dhe pjesëve të ndërtesave.
- Kryerjen e punëve profesionale , të cilat dalin nga shërbimi gjeodezik (ndryshimet e bërë gjatë matjeve nga Hartat e Kosovës dhe bartjen e tyre në programin e SIKTK-së.
- Kryerjen e shërbimeve për shënimet e digjitalizuara (dhenien e kordinatave për teren);
- Si dhe Shërbime profesionale dhe shërbime të tjera ,për subjekte dhe institucione të ndryshme;
- Si dhe për fund kemi marrë pjesë në trajnime, seminare të ndryshme për zhvillimin e njohurive që të jemi sa më transparent në kryerjen e shërbimeve ndaj Qytetarëve të Komunës.
- Në përfundim të këtij raporti për vitin 2021 konstatojmë se kemi arritë t'i përfundojmë varësisht prej natyrës së lëndëve, Kontrata të ndryshme, ndarje të parcelave, bashkimin e parcelave, modifikimin etributeve të parcelave, ndërtesave pjesëve të ndërtesave apo refuzim të kërkesave Vendime të ndryshme, Kërkesa të ndryshme, Certifikata mbi të Drejtat e Pronës së Paluajtshme, Kopje Plani , Certifikata që nuk posedojnë Pronë gjithsej 5916 kërkesa të ndryshme varësisht prej llojit të lëndëve .

#### **-SEKTORI I GJEODEZISË-**

Raporti përmban një përmbledhje në vijë të trasha të punëve gjatë vitit 2021.Në raport do të përfshihen punët e përfunduara nga sektori në aspektin profesional sipas kërkesave të parashtruara nga ana e drejtorive të KK Obiliq të cilat lidhen drejtpërdrejt me punë profesionale në teren e që janë situacione të ndryshme për nevojat e projektimit. Matje të parcelave – kufijve për ndërtimin dhe planifikimin e rrugëve, elaborate të shpronësimit dhe identifikime të ndryshme me matje.

Në cilësinë e anëtarit të komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar shumë në vitin 2021 pasi që natyra e punës kërkon dalje në teren në vendngjarje dhe në rastet kur punët kanë filluar realizojmë



matje gjeodezike për te përcaktuar pozicionin e saktë te objektit. Pas vendshiqimit të terrenit përpilohet raporti si dhe në rast te matjeve behet përpunimi i te dhënave ne forme te skicës duke i krahasuar te dhënat me gjendjen ne kadastër mbi pozicioni e objektit.

Pasqyra e lendeve te përfunduara ne kuadër te mirëmbajtjes se rregullt te kadastrit do te paraqitet me nje tabele te veçante dhe do t'i bashkëngjis këtij raportit ndersa ky raport me shkrim do te përfshijë vetëm punët dhe shërbimet qe janë kryer sipas kërkesave te Drejtorive brenda Komunës.

Ne cilësinë e anëtarit te komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore është punuar ne gjithsejtë 114 lende gjate vitit 2021, ne disa prej lendeve janë bere matjet për përcaktimin e pozicionit te objekteve dhe janë punuar skicat se bashku me raportin e komisionit. Gjithashtu ne cilësinë e anëtarit te komisionit për rrenim te objekteve gjate vitit 2021 ka pas 6 (gjashte) kërkesa te cilat janë shqyrtuar ne afatin ligjor.

Raporti përmban punët nga lëmia e punëve inxhinjerike gjeodezike për projekte te ndryshme komunale ndërsa punët ne lëmin e mirëmbajtjes se rregullt te kadastrit do ti paraqesim ne forme tabelarë për çdo zone kadastrale si dhe totali i lendeve te përfunduara ne vitin 2021.

Gjate vitit 2021 është punuar shume ne legalizimin e objekteve sipas ligjit për legalizim, objektet te cilat marrin Vendimin për Certifikatë te Legalizimit regjistrohen ne pjesën grafike dhe tekstuale te Kadastrit, ne këtë proces janë legalizuar objekte ne baze te Vendimit për Certificate te Legalizimit gjithsejtë sipas zonave me sa vijon:

- zk Babimoc.....1 (nje) objekt
- zk Bakshi.....4 (kater) objeke
- zk Mazgit.....17 (shtatembedhjete) objekte
- zk Millosheve.....4 (kater) objekte
- zk Obiliq.....61 (gjashtedhete e nje) objekte
- zk Plemetin.....6 (gjashte) objekte
- zk Plemetin.....5 (pese) objekte

Gjithsejte **98** objekte te regjistruara ne kadastër ne procedure te legalizimit.

#### **Pasqyra e punëve sipas zonave**

Në zk Obiliq janë bërë matjet për legalizim të objektit te tregu i ri dhe i njëjti është regjistruar në kadastër sipas njërive qe përmban, janë bere matje te kanalizimit përballe ftohëseve te Kosova "A" lagjia Subotiq, për nevoja te projektimit është hartuar situacioni. Për nevoja te projektimit është punuar-matur situacioni i terreni te Posta e qytetit Obiliq, gjithashtu është punuar- matur situacioni i terrenit ne pronën komunale Obiliq i vjetër për nevoja te hartimit te projektit. Janë bere disa matje te kufijve te rrugëve me kërkesën e

drejtorisë se infrastrukturës për nevoja te punimit te rrugëve, si dhe matje te objekteve ne cilësinë e anëtarit te komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore.

Ne Llazarevë me kërkesën e drejtorisë se Infrastrukturës janë bere matje te situacionit te terrenit ne pronën komunale për hartimin e projektit te fushës sportive, gjithashtu janë bere matjet ne përcaktimin e kufijve te rrugës te zona industrial Llazarevë.

Ne Mazgit janë bere disa matje ne përcaktimin e kufijve te rrugëve me kërkesën e drejtorisë se infrastrukturës .

Ne Millosheve matjet e rrugës qe shpie nga obilqi i vjetër ne Millosheve

Ne Plemetin janë bere matje ne cilësinë e anëtarit te komisionit për kushte ndërtimore

Ne zk Bakshi jane bere matjet ne përcaktimin e kufijve te rrugës për nevoja te punimit te rrugës nga ana e drejtorisë se infrastrukturës.

Te gjitha punët e përshkruara me larte kërkojnë pune përgatitore ne zyre dhe pune ne përpunimin e te dhënave ne formën digjitale te cilat marrin kohe te konsiderueshme ne finalizim e situacioneve dhe skicave varësisht prej natyrës se punës.

Gjate viti 2021 ka pas mjaftë kërkesa zyrtare nga palët për matje kadastrale kryesisht ne përcaktimin e kufijve te rrugëve gjate punimit te rrugëve.

Pune ne cilësinë e anëtarit te komisionit për pranimin teknik te projekteve komunale.

Ne cilësinë e anëtarit te komisionit për caktimin e kushteve ndërtimore gjate vitit 2021 ka pas gjithsejtë 114 lende te cilat janë shqyrtuar brenda afatit te parapare me ligj.

#### RAPORTI VJETOR 2021

Pasqyra vjetore e lendeve nga Regjistri i Fletëparaqitjes 2021						
Zona Kadastrale	Ndarje	Bashkim	Shpronësim	Korigjim Kufirit	Ndërtesa	Total
Babimoc	4	3	-	1	1	9
Bakshi	4	-	-	-	-	4
Breznicë	3	2	-	-	-	5
Caravodicë	2	-	-	-	-	2
Graboc i Epërm	-	-	-	-	-	0
Hade	-	-	-	-	-	0
Hamidi	-	-	-	-	-	0
Kryeshevc	8	7	-	1	-	16
Leshkofshiq	2	1	-	-	-	3
Llazarevë	-	-	1	-	1	2

Milloshëvë	13	5	-	1	4	23
Mazgit	7	2	1	1	17	28
Obiliq	58	21	-	8	67	155
Plemetin	10	2	-	1	4	17
Raskovë	8	2	-	2	5	17
Siboc	4	1	-	-	-	5
Shipitullë	4	-	-	-	-	4
<b>Total</b>	<b>127</b>	<b>46</b>	<b>2</b>	<b>15</b>	<b>100</b>	<b>290</b>

#### **-SEKTORI I URBANIZMIT-**

-Gjatë vitit 2021 sektori i urbanizmit në kuadër të DPUPK ka qenë i ngarkuar me punë të natyrave të ndryshme që kanë qenë të paraparë me plan program si ato në zgjidhjen e kërkesave të palëve, përgjegjësit brenda Komunës, pjesëmarrjet në takime jashtë komunës, pastaj trajnimet e ndryshme, e shumë punë të tjera të lidhura me këtë sektor, ku të gjitha këto fushëveprime janë përmbyllur me sukses gjatë tërë vitit.

-Plotësimi I formularëve të performancës për vitin 2021, e cila përsëritet qdo fund vit, kërkesë e MAPL.

-Raporti çdo tre muaj ASK-së (Agjensioni i Statistikave të Kosovës) për punën lidhur me lejet ndërtimore

-Pjesmarrja në trajnimin për Planifikim Hapësinor e organizuar nga GIZ dhe Asociacioni i Komunave lidhur me aplikimin si dhe analizën në zbatimin e Ligjit dhe Udhëzimeve Administrative në fushën e Planifikimit Hapësinor, ku ne si sektor së bashku me komunat tjera kemi takime të përherëshme që një periudh të gjatë kohore në mënyrë që procedura Ligjore të zbatohet në përpikmëri.

-Takim dhe Komunikime të përherëshme me USAID lidhur me procedurat e trajtimit të lëndëve për legalizim të objekteve pa leje si dhe njohja me programin për regjistrimin e lendeve në sistem për procedurat e legalizimit të objekteve, kemi mbështetjen nga Usaid sepse është bërë memorandum bashkëpunimi ndërmjet kryetarit dhe USAID pasi kemi dalë me performancë shumë të mirë në si sektor lidhur me aplikimin e këtij Ligji si dhe trajtimin e lëndëve të legalizimit.

-Puna e vazhdueshme në Hartimin e Planit Zhvillimor të Komunës, takimet me kompanit e ndryshme, takimet me komision, me grupet e interes, një punë intensive me përgjegjësi maksimale.

-Kemi filluar me punë së bashku me kompanin konsulente dhe komisionin e Komunës për hartimin Hartën Zonale të Komunës së Obiliqit, kemi pasur katër takime dhe jemi duke u harmonizuar me dokumentin e Planit Zhvillimor të Komunës i cili është në fazat përfundimtare.

-Kemi pajisur palët me dokumente në mënyrë që t'iu mundësohet aplikimi në Ministrinë e Bujqësisë për përfitim të granteve qeveritare e po ashtu edhe bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale lidhur me kërkesat e tyre për ndërtimin e shtëpive për të rikthyerit dhe për minoritete.

-Takim me auditor, lidhur me procedurat e paisjes me leje ndërtimore për vitin 2021-ashtu siq është vepruar çdo vit.

-Jemi ndarë të knaqur çdo herë me Inspektoratin e MMPH, lidhur me kontrollet e kohëpaskohshme që i bëjnë sektorit tonë për rrjedhën e punëve lidhur me pajisjen e palëve me leje ndërtimore dhe zbatimin e proceduarve ligjore në përpikëri.

-Mbajtja e debateve publik me qytetar rreth punës që është zhvilluar në kuadër të Planit Zhvillimor të Komunës se Obiliqit.

-Si dhe shumë punë të tjera që janë të lidhura me sektorin e urbanizmit, duke cekur edhe konsultimet me palë lidhur me punët që I takojnë natyrës së punës tonë.

-Kjo ka qenë një përmbledhje e shkurtër e punëve të sektorit të urbanizmit gjatë vitit 2021.

**-Më poshtë do të cekim lëndët që janë të lidhura me të hyrat në sektorin tonë.**

- 104 vendime për kushte ndërtimore,
  - 87 vendime për leje ndërtimore,
  - 7 leje përdorimi,
  - 8 leje rrënimi,
  - 10 vendime për refuzim,
  - 6 pelqim ,
  - 9 përgjigjëje palëve,
  - 20 njoftime për qytetarë në kërkesat e ndryshme.
- 
- 106 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e parë
  - 6 vendime të legalizimit të objekteve për kategorin e dytë.

- 21 vendime të legalizimit për listë të pritjes.

Të hyrat nga lejet ndërtimore : 183 782.90 euro

Të hyrat nga legalizimi I objektev: 22 741.11euro

**TOTAL 206 524.0 EURO**

**DREJTORIA PËR BUJQËSI DHE ZHVILLIM RURAL – RAPORTI I PUNËS 01.01.2021-  
31.12.2021**

Drejtoria për Bujqësi dhe Zhvillim Rural duke u mbështetur në Kompetencat dhe bugjetin e ndarë për subvencionimin e fermerëve të komunës tonë ka zhvilluar këto aktivitete . Duke i dhënë prioritet zhvillimit të bujqësisë, mbështetja ka filluar me përkrahjen e sektorit të blegtorisë, Perimtarisë ekonomive të vogla familjare bujqësore, dhe rritjen e interesimit të qytetarëve për qasje me konstruktive në këtë lëmi..

**AKTIVITETET E PUNËS**

